



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0175**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Enggroup” SH.P.K, kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”, më 30/04/2024, mori këtë:

### Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Enggroup” SH.P.K. me nr. 2024/0175, e datës 29/02/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së”, me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”.

2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – “KK Prishtinë” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.04.2023, “KK Prishtinë”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1. Ndërsa me datën 16.02.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku

ka shpërblyer me kontratë OE " HARST Group SHPK & NIVA Construction SHPK & EKOTERMIKA SHPK."- Prishtinë

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1.100.000, 00 €

Me 20.02.2024, OE "Enggroup" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.02.2024, Autoriteti Kontraktues e ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29/02/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Enggroup" SH.P.K me nr. 2024/0175 lidhur me aktivitetin "Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Enggroup" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: "Lidhur me arsyetimin e eliminimit sa i përket pikës 1, Autoritet Kontraktues, gabimisht i është referuar gjendjes faktike, përkatësisht përgjatë gjithë procesit të këtij aktiviteti të prokurimit janë shkelur parimet e përgjithshme të Prokurimit publik dhe dispozitat ligjore në fuqi. Konfirmimi i shkeljeve ligjore dhe parimeve të prokurimit publik konfirmohet, me rastin e vlerësimit fillestar të ofertave ku kompania jone është kualifikuar si e përgjegjshme por e pa suksesshme. Provë raportet e vlerësimeve dhe letrat standarde përgjatë vlerësimit dhe ri vlerësimit të ofertave të bashkangjitura në platformën e-prokurimi.

Çuditërisht tani ne eliminohe mi si të papërgjegjshëm me arsyetim absurd kinse neve nuk e kemi autorizuar liderin e grupit. Ne si OE ankues ne oferte kemi prezantuar të gjitha provat dhe dëshmitë dokumentare përmes të cilave konfirmohet përgjegjshmëria e ofertës sonë, përfshirë edhe deklaratën e krijimit të grupit, autorizimin, përfshirë procedurën e prokurimit, nr. e prokurimit, aktivitetin e prokurimit, palët e përfshira në aktivitet të prokurimit dhe përcaktimi i liderit të grupit i potencuar në nenin 3 të marrëveshjes. Neni 3 i kësaj marrëveshje shumë kjoartë përcakton se partner udhëheqës është "Enggroup" shpk.

Ne si OE nuk jemi të kjoartë se çka ka matur komisioni i rivlerësimit të ofertave në rastin e referimit të pikës C të pikës 11 të FDT-se. Pika C është e kjoartë" Një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të

grupit". Prova e sipër prezantuar tregon se "Enggroup" SFIPK është autorizuar si lider i grupit, deklarata është e nënshkruar dhe vulosur nga të gjithë anëtarët e grupit dhe i përmban të gjitha kërkesat e pozicionit C.Neni 26 i Rregullores për Prokurim publik nr. 001/2022 "Grupi i OE-ve", par. 2, kjoartë përcakton qe: "Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokumentNeve si OE nuk po arrijmë të kuptojmë se pse AK, detyrimisht tenton te eliminoi ofertën tone dhe pse detyrimisht po tento te keqpërdor paranë publike dhe te lidhe kontrate me oferte e cila përmban çmimin dukshëm me te larte se ajo e jona. Për konsistence eksperti i autorizuar përveç bazës ligjore nga neni 71 i LPP-se, nenin 26 i RRPP-se nr. 001/2022, mund ti referohet edhe ueb faqes se OSHP-se ku është gjykuar dhe vendosur ndryshe nga AK - Komuna Prishtinë."

Pretendimi ankimor 2: "Edhe ndaj arsyes se dyte te eliminimit, Autoriteti Kontraktues - Komuna Prishtine ne vlerësimin fillestar e ka kualifikuar si të përgjegjshme ofertën tone dhe për çështjen e paramases dhe parallogarisë. Tani pas procesit te rivlerësimit te ofertave potencohet se "Grupi i OE-ve ankues me rastin e dorëzimit te ofertës tek pozicioni 4.6 dhe 4.7 z paramases, për këto pozicione është dhënë çmim për njësi por nuk është plotësuar kolona fundit --- çmimi total për pozicion

Kjo çështje është e rregulluar me dispozita ligjore, përkatësisht ne vlerësimet paraprake për këtë çështje ne si OE nuk qëndron fare, pasi qe ne paramasë dhe parallogari për këto pozicione Autoriteti Kontraktues, fare nuk ka përcaktuar sasinë por ka përcaktuar vetëm njësinë dhe ky veprim ne këtë faze te prokurimit, përkatësisht pas hapjes se ofertave bie ndesh me nenin 44, nga pika 2 dhe 3 e Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 përcaktohet:

44.2 "Përdorimi i formularëve standard" do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar.

44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde.

Pra hartimi i formave standarde është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues dhe nuk është përgjegjësi e Operatorit Ekonomik, rrjedhimisht për lëshime dhe gabime te tilla ne nuk mund te pësojmë ne si OE, rrjedhimisht ofertimi ne procedurë te prokurimit ka kosto financiare dhe kosto tjera, për te cilat AK duhet te marr përgjegjësi dhe jo ofertuesi te pësoj aq me pak ne këtë fazë te procedurës s e prokurimit, kur neve fillimisht jemi kualifikuar si te përgjegjshëm.

Pikërisht për këtë çështje Autoriteti Kontraktues në vlerësimin fillestar të ofertave ka potencuar se këto pozicione nuk janë të rëndësishme dhe nuk do të realizohen fare ndërsa tani arsyetimi i tillë bie ndesh me nenin 52.3, përkatësisht 56.3 të LPP-së, ku përcaktohet:

- 44.4 Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkt me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.

Provë: shiko vlerësimin fillestarë të ofertave dhe përgjigjet ndaj kërkesave për rishqyrtim të ngarkuara në e-prokurim.”

Pretendimi ankimor 3: “Sa i përket arsyetimit të trete të eliminimit, ku AK, ka potencuar se “Plani dinamik i prezantuar në oferte nuk është dorëzuar në mënyrë të detajuar paraqet shkelje ligjore pasi që në pozicionin 4 të pikës 9.1 dhe 9.2 të FDT-se, si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Planin dinamik duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik” Në si OE në oferte kemi prezantuar planin dinamik bazuar në kërkesën tuaj të përcaktuar në Dosje të Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Plani dinamik i prezantuar nga ne si OE i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe i njëjtit i përmban të gjitha veprimet në mënyrë të detajuar që nga fillimi i realizimit të projektit deri në përfundim të të njëjtit. Rrjedhimisht, AK me arsyetim të tillë të eliminimit, ka shkelur parimet bazike të LPP-se ku tentohet të lidhet kontratë me oferte të cilat përmban çmim dukshëm më të lartë sesa oferta jone, ndërsa eliminohet oferta jone përkundër faktit se e njëjta është e përgjegjshme.

Edhe në këtë rast, AK- Komuna Prishtinë ka tejkalluar kërkesat e përcaktuara në DT dhe keni konsumuar shkelje ligjore nga neni 52.3, 56.3 dhe 59.3 të LPP-së duke dhënë arsye të eliminimit për kërkesa të cilat nuk janë përcaktuar fare në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë. Në vendim kundrejt kërkesës për ri shqyrtim potencohet se plani dinamik i punëve nuk përmban afatin kohor, nuk përcaktohet mënyra e veprimit, numri i punëtorëve, kapacitetet e punës gjatë festave apo detaje tjera.

Ky arsyetim le për të kuptuar se ka qëllim të caktuar dhe eliminim të detyrueshëm të ofertës sonë. Ky aktivitet i prokurimit përmban periudhë kohore të përcaktuar për të realizuar. Në si OE, para se të ofertonim i kemi marrë parasysh planin dinamik periudhën e realizimit të kontratës dhe kemi ofruar deklaratë tjera përmes të cilave ka konfirmuar se kontrata do të realizohet ashtu siç është kërkuar nga AK. Sa i përket numrit të punëtorëve në kemi prezantuar dëshmi prova çdo gjë tjetër që është kërkuar lidhur me stafin e kualifikuar dhe stafin mbështetës. Në plan dinamik nuk është kërkuar apo përcaktuar që të përshkruhet numri i punëtorëve, veprimet apo mos veprimet përgjatë vikendeve apo edhe festave.

Ekzistojnë ligje tjera sa i përket te drejtave të punëtorëve .AK - Komuna Prishtine do duhej te vlerësoj dhe gjykoj bazuar dispozita te LPP-se, rrjedhimisht nuk është faji ynë nëse plani dinamik nuk mund te deshifrohet. Për tu kuptuar një gjë e tille do duhej qe ne vlerësimin te ofertave te përfshihej staf i kualifikuar.

Çuditërisht ne vlerësimin fillestar të ofertave edhe për këtë çështje ne si OE keni qen të përgjegjshëm.”

Pretendimi ankimor 4: “Sa i përket ofertës të cilën e keni rekomanduar për dhënie te kontratës rezulton qe e njëjta është e pa përgjegjshme ne shumë aspekte. Në paramasë dhe paralogarit ka ofruar çmimin për pozicione te cilat nuk disponojnë me sasi fare (shiko pozë. Nr.4.6 dhe 4.7, rrjedhimisht ne kuptim te nenit 59 te LPP-se, rezulton qe te njëjtit kanë ndërhyrë ne paramas dhe kanë ofertuar përkatësisht ofruar çmim total për pozicion abstrakt i cili nuk posedon njësi apo sasi. Ne matematike si shkence ekzakto 0 (zero) x 1 është e barabartë me 0 (zero) dhe asnjëherë nuk është rezultati 1, prandaj OE i cili është rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar vlere e cila është kalkuluar dhe pranuar nga AK- Komuna Prishtine e qe gjithësisë kemi te bëjmë me ndryshim material ku këto ndryshime janë te ndaluara rreptësishtë me dispozita ligjore dhe nënligjore, madje AK, nuk e merr fare mundin qe te përmirësoj apo korrigjoj ofertën.

Po ashtu edhe për stafin teknik i grupit të OE-ve te cilët i janë rekomanduar për dhënie te kontratës nuk i plotësojnë kërkesat kualifikuese dhe nuk kane prezantuar certifikime ne mënyrën e kërkuar përkatësisht janë prezantuar trajnime nga institucione te pa akredituara dhe te dyshimta te cilat fare nuk janë shqyrtuar nga AK komuna Prishtine ku me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 8.4 te nenit 108/A, te LPP-se.- Provë: Bashkangjitur gjeni planin dinamik.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7, 24, 52, 56, 59, 69, 71 i LPP-së 40 dhe 97 rregullores për prokurimit publik 001/2022 . Duke propozuar qe ankesa të aprovohet, ne tërësi ankesa si te bazuar, Të Obligohet AK - Komuna Prishtine, qe te realizoi vlerësim dhe krahasim te ofertave ne mënyrë korrekte ne raport me kërkesat e aplikuara ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate ashtu siç janë përcaktuar dhe lenden ta kthej ne Rivlerësim.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (m meritum) të kërkesës.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor: fillimisht duhet sqaruar se në dosjen e tenderit është përcaktuar si vijon: Krijimi i një grupi të operatoreve e ekonomik

- a. “një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;

- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe
- d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Secili antarë i grupit duhet të jete i regjistruar në platformën elektronike”.

Nga oferta e parashtruesit është gjetur se i njëjti nuk ka dorëzuar një deklaratë sipas pikës c) të nenit 11.1 në dosjen e tenderit ku kërkohet "një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit". Duhet cekur se parashtruesi ka dorëzuar një dokument me titull "marrëveshje partneriteti" e cila nuk i referohet aktivitetit të prokurimit sipas titullit dhe numrit të prokurimit për të cilin po bëhet fjalë. Nga cilido këndvështrim ky dokument nuk është deklaratë që i referohet këtij aktiviteti të prokurimit sikurse kërkohet me dosjen e tenderit të cituar më sipër. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor: është gjetur se parashtruesi në pozicionin 4.6 dhe 4.7 të paramasës ka ofruar çmim për njësi por nuk e ka plotësuar kolonën e fundit për çmimin total për pozicion. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor: fillimisht duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim është si vijon "4.Operatori ekonomik duhet të paraqet një plan dinamik me një përshkrim të detajuar". Në ofertën e parashtruesit është bashkangjitur një plan dinamik një faqe A4 ku janë përcaktuar punët që do të kryhen dhe një afat kohor për këto punë. Asnjë e dhënë shtesë nuk është përcaktuar në këtë dokument për të sqaruar mënyrën e veprimit, numrin e punëtorve, kapacitetin e punës gjatë festave dhe vikendeve, apo detaje tjera të punës. Pra plani dinamik nuk është aspak i detajuar sipas dosjes së e tenderit. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e katërt ankimor: është gjetur se parashtruesi e ka vazhduar validitetin e ofertës prandaj pretendimi i katërt ankimor është pretendim i bazuar.

Lidhur me pretendimin e pestë ankimor: nga sa u tha më sipër është konfirmuar se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj nuk mund të manifestoj asnjë interes material në raport me pretendimin e tij të pestë të parashtruar kundër tenderuesit të rekomanduar. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me pretendimin e pestë në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se

"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezidanti i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Prandaj pretendimi është i pabazuar.

"Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pretendimin e tij nr. 4 mirëpo nuk ka arritur që të parashtrorj argumente apo dëshmi sa i përket pretendimit me nr. 1, 2, 3 dhe 5. Prandaj është vendosur që kërkesa për rishqyrtim të miratohet vetëm në raport me pretendimin 1.2 të parashtruesit por edhe jo edhe në raport me pretendimet tjera. Megjithatë miratimi i pretendimit me nr. 4 nuk ka manifestuar efekte juridike të mjaftueshme për të anuluar njoftimin mbi vendimin dhe për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Kjo për arsye se parashtruesi është i papërgjegjshëm në raport me arsyet tjera për eliminimin e tij për çka janë refuzuar si të pabazuara edhe pretendimet ankimore me nr. 1, 2, 3 dhe 5. Prandaj parashtruesi nuk do të mund të manifestoj asnjë interes juridik nga rivlerësimi eventual në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit ndërsa është vërtetuar njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/03/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0175/24, ndërsa, me datë 15/03/2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2024/0175 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh pretendimet ankimore, analizimin e dosjes se tenderit dhe dokumentacionit të ofertës ne cilësinë e ekspertit shqyrtues rekomandoj Panelin Shqyrtues që të aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik dhe njëkohësisht të vërtetoj, te lej ne fuqi Njoftimin, Formularin B58 (për dhënie të kontratës) të rekomanduar nga ana e AK-së, Komunës se Prishtinës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Enggroup" SH.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0175 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: Lidhur me Marrëveshjen e themelimit të Grupit të Operatoreve.

Krijimi i grupit te operatoreve ekonomik rregullohet konform LPP - së Nenit 71 dhe kriterëve te përcaktuara ne dosjen e tenderit tek pika 11.1.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore te ngritura nga ane OE ankues pas shqyrtimit te dokumenteve të dorëzuar ne ofertë ka vërejtur se grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar këtë marrëveshje: "marrëveshja e partneritetit"

Ne marrëveshjen e dorëzuar vërehet shumë qarte se nuk figuron titulli i projektit ose prokurimit se për qfar është bër marrëveshja.

Me gjithat grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar edhe një shkresë tjetër me titullin Konzorciumi i projekti ne këtë shkresë ne Nenin 3 është përcaktuar ,"Enngrup" si partner udhëheqës dhe nënshkrues i dokumenteve. Lidhur me këto qështje AK konform LPP Nenit 72 ka pasur mundësin e kërkimit te sqarimeve për marrëveshjet e bashkëpunimit mesë operatoreve ekonomik.

Dosja e tenderit pika 11.1 nënpika a) cekë: një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; Deklarata e tillë nuk është dorëzuar nga grupi i operatoreve ekonomik. Në bazë të dëshmimeve ky pretendim është i pjesërisht i bazuar

Pretendimi ankimor 2:Vendosjen e çmimeve ne paramas tek pozicioni nr.46 dhe 47 por qe nuk është plotësuar kolona e fundit me çmimin total konform pozicioneve.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit dhe dokumentacionit, shqyrtimit te çmimeve te vendosura ne paramas është vërejtur se operatorit ekonomik ka vendosur çmimet për njësi por që nuk është vendosur kalkulimi përfundimtar sipas vendosjes se çmimeve. "si ne tabelën e dhënë ne ekspertizë"

Në këto raste Autoriteti kontraktues është i obliguar që konform Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, Nenit 40 pikës 40.9 nënpikës a) që te bëj korrigjimet, përmirësimet krejtësisht aritmetikore jo më shumë se sa 2%.

a. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. Bazuar ne këtë pretendimi ankimore është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3: Plani Dinamik



Autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit piken 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar si vijon: “4. OE duhet te paraqet një plan dinamik me një përshkrim te detajuar”, “4. Paneli dinamik duhet te jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE”

Grupi i operatoreve ekonomik ka prezantuar ne ofertë një plan dinamik, ne formë tabelore, pas analizimit të kërkesave ne DT ku është kërkuar që plani të jetë me një përshkrim te detajuar i njëjti nuk përmban përshkrim detal të pozicioneve për veç formës tabelore me katrorë andaj bazuar në kërkesën e dosje se tenderit plani nuk përmban përshkrimin e detajuar dhe pretendimi ankimore konsideroj se është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 4: Lidhur me porcionin e 4.6 dhe 4.7 te çmimeve ne paramas ku pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar ka bër ndërhyrje, si dhe mos plotësimi i kërkesave te stafit teknik nga ana e operatorit ekonomik te rekomanduar.

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues ne paramasen dhe parallogarit e çmimeve ne Excel ka vendosur sasi të si njësi (vetëm 1) dhe ka vendosur dhe publikuar këtë paramas:

Paramasa e publikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në paramasën e AK te publikuar ne sistemin e prokurimit shihet shumë qartë se ne pozicionin nr.4.6 dhe 4.7 nuk është vendosur sasisë nga AK, por pasur parasysh se procedura dhe paramasa ka te bëj vetë me sasi të, njësit „1” kjo nënkupton që edhe në këto pozicione sasia apo është 1 dhe operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka vendosur vetëm çmimin për njësit dhe i njëjti nuk ka bër ndërhyrje ne paramas sipas pretendimi të operatorit ekonomik ankues.

Paramasa e operatorit ekonomik te rekomanduar.

Në këto raste Autoriteti kontraktues është i obliguar që konform Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, Nenit 40 pikës 40.9 nën pikës a) që te bëj korrigjimet, përmirësimet krejtësisht aritmetikore jo më shumë se sa 2% gjatë fazës se vlerësimit, por me qenë se nuk ka gabim aritmetik te paraqitur nga ana e grupit te operatoreve ekonomik pasi qe i njëjti ka vendosur çmimet për sasi të/njësit dhe nuk ka gabim aritmetik ne llogaritje AK ka vlerësuar dhe konstatuar si te drejt këtë, dhe se pretendimi ankimore se operatorit ekonomik i rekomanduar ka bër ndërhyrje ne paramas nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Lidhur me pikën, pretendimin se operatori ekonomik i rekomanduar nuk plotëson kriterin e stafit teknik lidhur me këtë pikë autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit ka kërkuar si ne vijim: “stafi teknik”

Lidhur me kërkesën e AK grupi i operatoreve ekonomik ka paraqitur listën e stafit teknik sipas kësaj kërkesë:

Lista e stafit teknik me pozicionet e punës sipas kërkesës se AK-së

Bazuar në dosjen e AK grupi i operatoreve ekonomik konform kërkesës ka dorëzuar listën e stafit teknik sipas pozicioneve dhe profileve të kërkuara po ashtu i njëjti ka dorëzuar edhe certifikimet e kërkuara për një pjesë të stafit nga lista e prezantuar, AK në dosjen e tenderit nga lista e stafit teknik ka kërkuar që pozicioni apo profilet si në vijmë të kenë certifikime:

Një (1) punëtorë i certifikuar për hidroizolime,

Një (1) teknik I elektros i certifikuar programin e efciences te energjisë ,

Një (2) saldues i certifikuar

Për këto profile të kërkuara me certifikim grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për dhëni ka dorëzuar certifikatat si në vijim: Certifikata për profesionin Hidroizolues e punëtorit nga lista z.Sokol Gashi.

Duke pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe shqyrtimin e pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të ofertës eksperti shqyrtues konstaton se edhe ky pretendim ankimor se grupi i operatoreve ekonomik nuk plotësonë kriterin e Stafit teknik nuk qëndron dhe se pretendimi ankimor është **i pa bazuar.**”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Enggroup” SH.P.K, Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertës shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Enggroup” SH.P.K, janë **pjesërisht të bazuara.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve

ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit me rekomandim, andaj, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa është pjesërisht e bazuar, por mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertitshqyrtues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KK Prishtinë” të datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe përmirësimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me nr. të prokurimit: 616-23-4220-5-1-1. Pas analizimit të shkresave të lëndës, dëshmitë e Operatorit ekonomik dhe konstatimit të ekspertit shqyrtues vërehet se ankuesi në këtë rast ka disa mangësi të cilat janë të pariparueshme në këtë rast, e sidomos pjesa apo arsyetimi i autoritetit kontraktues sa i përket planit dinamik, i cili nuk është konform kërkesës së Dosjes së Tenderit, që është kërkuar të jetë sa më i detajuar, nëse bëhet edhe krahasimi i planeve dinamike në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE ankues në këtë rast vërehet se ka dallim të madh, OE i rekomanduar për kontratë ka një plan dinamik prej 8 faqeve që është i përfshirë secili pozicion, ndërsa, tek plani dinamik i OE ankues është vetëm një faqe dhe nuk përfshinë të gjitha pozicionet por vetëm situacionet kryesore (grupet e pozicioneve)

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtën AK dhe që do të jetë në fuqi vendimin e AK, vendim ky që është vendimi i një komisioni i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”, atëherë në përbimë të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta zgjasë aktivitetin e prokurimit. Edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye

konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përfundim të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i ligjit është mes tjerash, cituar: "...të sigurtë integritetin dhe përgjegjësinë e tyre. zyrtarëve, nëpunësve civilë dhe të tjerëve që kryejnë janë të përfshira në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e tyre janë të tilla dhe baza ligjore faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo - diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të të gjitha këto procedurale dhe qenësore të ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkuara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e ekspertëve.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " Enggroup " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: